



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 1751 Prot.
8

Patos më 16 .06.2025.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 13.06.2025

I mbajtur sot më datë 13.06.2025 në orën 15:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë :

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltarë:

1. Armand Ahmetaj
2. Zejni Musaj
3. Liljana Mesutaj
4. Artan Velçani
5. Ertilla Myrtaj
6. Elton Seraj
7. Suela Hoxha
8. Smerald Hazizaj
9. Elmira Rama
10. Renaldo Shpata
11. Novrus Toska
12. Eduart Faslliaj
13. Zejni Musaj
14. Gani Ahmetaj

Të nderuar qytetar!

Të nderuar anëtar të këshillit bashkiak!

I nderuar Kryetar i Bashkisë!

Jemi në këtë mbledhje jashtë radhe të këshillit bashkiak, mbledhje e kërkuar nga Kryetari i Bashkisë, bazuar në kërkesën që daton 05.06.2025, nr. Prot 1751. Bazuar në nenin 53 pika 3 bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" si dhe nenit 59 i Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin të Këshillit Bashkiak.

Pjesëmarrja në mbledhje është 14 (katërbëdhjetë), pra kuorumi ligjor është në rregull.

Kalojmë në leximin e rendit të ditës i cili është si më poshtë:

1- Miratimi i rendit të ditës.

2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 26.05.2025.

3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 26.05.2025.

4- Projekt-vendim "Për miratimin e përdorimit të fondit të planifikuar në programin e emergjencave civile nga objekti "Blerje pajisje korrëse automatike për ndërhyrje në raste emergjente" në objektin "Ndërtim të mureve mbajtës përgjatë rrugës "Ymeraj", Gjyngarë me qëllim parandalimin e rrëshqitjes së rrugës" (Blerje bazë materiale).

Kush është dakord me rendin e ditës?




Kundër s'ka, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARI

Refaela Xeba

KRYETARI

Armand Ahmetaj

1. Artan Velconi 
2. Eduart Foshliq 
Penshola Shpata 



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 175 Prot.
19

Patos më 16.06.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 13.06.2025 në orën 15:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 26.05.2025.

Armand Ahmetaj- Materiali është përpara i firmosur sipas rregullave.
Kemi ndonjë vërejtje apo paqartësi?

Nëse s'ka gjë tjetër miratohet procesverbali i mbledhjes datë 26.05.2025.

SEKRETARI
Refaela Xeba

KRYETARI
Armand Ahmetaj

Artan Velcani
Edmont Folligj
Rendita Shyreta



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 1751 / Prot.
10

Patos më, 16 06.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 13.06.2025 në orën 15:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 26.05.2025

Armand Ahmetaj – Të lutem Refaela!

Refaela Xeba , Përshëndetje të gjithëve! Në mbledhjen e datës 26.05.2025 janë marrë gjithsej tetë vendime nga numri 20 deri në 27, të gjitha vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorisë përkatëse për ekzekutim.

Nga këto 8 vendime vetëm vendimi nr. 24 i është përcjell Prefekturës dhe ka ardhur përgjigja në përputhje me ligjin.

SEKRETARI
Refaela Xeba

KRYETARI
Armand Ahmetaj

Artan Velcanaj
Edmond Koshaj
Rendita Shpota



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 1751 Prot.

Patos më 16.06.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë, 13.06.2025 në orën 15:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt- vendim “Mbi miratimin e shërbimit të transportit publik të linjës Patosi i Ri- Mustafa Mtohiti-Margëlliç me mjete transporti të bashkisë, miratimin e vlerës së biletës si tarifë për mbulimin e shërbimit me mjete transporti”.

Kryetar i Bashkisë - Përhëndetje!

Ju falenderoj që keni ardhur sot pavarsisht se ishte mbledhje shumë e shpejt por duke patur parasysh se ne kemi filluar rrugën e Gjyzoqarës nga punimet që po kryhen nga Agjencia e Shërbimeve Publike dhe nga punimet është konstatuar se në disa segmente të saj është e nevojshme ndërtimi i disa mureve mbajtës, një mur mbajtës në pjesën e poshtme të rrugës dhe një në pjesën e sipërme të rrugës.

Gjithashtu edhe punimet për ndërtimin e mureve do të kryhen nga ana e Agjencisë së Shërbimeve Publike për të ulur pjesën e kostos punëtorisë vetëm betoni do të meret i gatshëm, do të meret vetëm baza materiale të gjitha të gjitha punimet e tjera do të kryhen nga Agjencia e Shërbimeve Publike.

Ndryshimi i zërit që ishte blerje korse automatike është hequr për arsye sepse ajo është e përfshirë te traktori që do të blihet bashkë me fondin që erdhi nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtës Civile dhe nuk ishte nevojshme më që të ishte si zë ose si shpenzim tek fondi emergjencave civile të bashkisë ndaj është bërë ky ndryshim duke qenë se kemi dhe përdorimin e pjesën tjetër të fondi emergjencave civile që kaloi mbledhjen e kaluar për vazhdimin e prroit në lagjen e Re edhe fillimi e prroit në Dukas, të rruga që shkon për te Perla dhe del dhe në Verbas.

Kësaj procedure do ti shtohet dhe vlera për blerjen e betonit dhe ndërtimin e mureve dhe të treja këto si punë do të kryhen nga Agjencia e Shërbimeve Publike dhe do të mbyllën brenda këtij viti.

Ky është pak a shumë një sqarim që duhej për të gjithë pjesën e mbledhjes që u bë tani. Është efekti kohës për shkak të mureve të Gjyzoqarës pasi duhet të ecim paralel me rrugën.

Shumë shpejt do të fillojnë shtresa asfaltike normalisht do të fillojnë edhe muret mbajtës.

Faleminderit!

Nëse doni ndonjë sqarim më thoni.

Eduart Faslliaj- Po them dy fjalë si zëvendës i komisionit të ekonomisë pasi kjo si pikë ose si material, projektakti nr. 26 kaloi në mbledhjen e komisionit të ekonomisë për shkak të mungesës së kryetares, bazuar mbi ligjin mbledhja u thërrit nga zëvendës kryetari. Projektakti u analizua dhe u miratua me tre vota pro.

Kisha dy pyetje në lidhje me projektin se unë e kam parë atje në vend, përgëzoj që filluat atje sepse ka kohë që po përflitet ky si projekt edhe hap pas hapi shkuam deri tani. Unë personalisht e gjykoj të domosdoshëm bërjen e murve mbajtëse sepse pa bërë ato mure gjithë ky investim do ishte jo i vlefshëm po doja t’ju thoja në projektin që keni parashikuar me këtë fond që keni deri ku shkojnë muret mbajtëse përse i përket gjatësisë rrugës?

Se gjatësia e rrugës fillon nga qendra e fshatit dhe përfundon tek shtëpia e fundit e lagjes Ymeraj.

Janë të shtirë në gjithë segmentin e rrugës këto mure mbajtëse dhe a ka pika të tjera ku do nevojiten mure të cilat do t'na dëmtojnë investimin?

A mjafton ky buxhet për ta bërë eficient atë si investim për të mos dalë jashtë loje?

Sa keni parashikuar në kohë që zgjasin bërja e mureve mbajtëse dhe kur fillon hedhja shtresave dhe asfaltimi i rrugës?

Kryetari i Bashkisë – Kjo vlerë fondi është afërsisht për 3 deri në 4 segmente muresh, janë më shumë në mos gaboj një segment 200m, një tjetër që është më i domosdoshmi nga të gjithë muret është një mur që është në pjesën e poshtme të rrugës dhe ka një gjatësi prej 50m deri në 55m që është i parashikuar dhe është i përfshirë tek këto mure, edhe janë dhe tre segmente të pjesës lart të mureve por duke qënë se tek të gjithë gjatësia e rrugës është e mundshme që të bëhet skarpatë dhe muri nuk është e nevojshme të jetë në një lartësi shumë të madhe. Muri më i lartë në mos gaboj do jetë deri në 1.5m ose 1.8 por duke qënë se kemi mundësi për skarpatë do ulët gjatësia e murit që ne të kemi mundësi për tu shtrirë në një gjatësi më të madhe me mure.

Besoj se me këtë fond dhe me këtë ndërhyrje që do të bëhet nga Agjencia e Shërbimeve Publike mund të ngelet ndonjë pjesë e vogël e patrajtuar për do të shohim që me bazën materiale që kemi në agjenci për momentin që të bëjmë dhe ndërhyrje tjetër të vogël.

Me këtë vlerë që të mbulosh të gjithë gjatësinë e rrugës Gjynaçarë nuk e mbulon dot por pjesat që janë problematike dhe mund të ketë rrëshqitje të dherave do të mbulohen.

Pjesa e afateve pritet përgjigje nga Prefektura dhe procedura e tenderimit që në këtë rast është e hapur që zgjat dhjetë ditë në sistem, pjesë vlerësimi e procedurës që është maksimumi dy javë pjesa dokumentacionit besoj se punimet atje fillojnë për një muaj, nëse çdo gjë ecën sipas afateve por punimet me shtresat asfaltike shtresat e çakullit dhe stabilizantit do të fillojnë më herët seç do fillojnë muret por asfalti për efekt që të mos ketë dëmtime të asfaltit kur të bëhen muret do fillojë momentin që do përfundojë armatura e mureve.

Punimet nuk do vonojnë sepse betoni do të jëtë i gatshëm por koha që të merret më shumë është armatura e mureve.

Eduart Faslliaj – Mua nuk më shqetësonte koha se ca rëndësia ka nëse vonon dhe dy muaj si projekt për tu realizuar por ideja është që a do arrijmë dot ne duke akordruar punimet se mos na ndodh si rruga e lapidarit në Margëlliç që bëm punimët, bëm shtrimin me asfalt dhe pastaj ndërhyri ujësjellsit dhe na e ka lënë sot e kësaj ditë ashtu. A do arrijmë dot ne ti akordojmë punimet për murët mbajtës ashtu siç ju thoni dy shtresat e para të çakullit, pastaj armaturën, pastaj heqja e armaturës vendosja e mureve pastaj asfaltimi? A do t'na dëmtojnë punët njëra tjetrën, këtë pata parasysht.

Kryetari i Bashkisë –Duke qënë se në Njësinë Administrative Ruzhdie aktualisht është duke u zhvilluar projekti i ujësjellsit dhe pjesa e Gjynaçarës, është bërë linja kryesore e ujësjellsit dhe ndarjet që janë bërë nëpër familje dhe ujësjellsit nuk do të ketë ndikim tek rruga e Gjynaçarës, plus edhe pak punë u ka ngelur edhe qoftëse nuk do ishin bërë të gjitha ndarjet e segment, shpërndarja e ujit në pjesën përsëri kemi kohë që mos të ketë ndërhyrje nga ujësjellsit tek rruga që do bëhet në Gjynaçarë. Nuk do ketë probleme të tillë atje, sepse pak a shumë kanë ecur ata të ujësjellsit dhe kemi ne kohë për të vazhduar.

Një nga arsyet që u vonua ka qënë pikërisht edhe vazhdimi ujësjellsit si ajo dhe dy rrugë që janë në Gjynaçarë dhe dy rrugë që janë në Siqecë.

Tek rruga e Gjynaçarës ka qënë një projekt por pas vlerësimit që u bë nga ana e inxhinierit ishte një projekt që nuk ishte i duhur për atë lloj rruge, kishte shumë mangësi si projekt dhe kostoja ishte artificialisht e lartë edhe do kishte ndërhyrje që nuk do ishin funksionale në momentin që të mbaronte, ishte një KUZ që shkonte deri në pikë edhe ishte me pusëtë fundore që nuk derdhej me asnjë vend, kur atje janë të gjithë me gropa septike. Pjesa e Kuz është e pamundur për ta bërë sepse ne u munduam dhe nuk ke pikë shkarkimi ku mund ta cosh, edhe u detyruam që ndryshonim projektin që është me kosto pesë herë më e ulur.

Eduart Faslliaj – Unë e di ku ishte përcaktuar dhe ajo puseta fundore por ajo çka më shqetëson mua në këtë investim ujërat e bardha janë parashikuar ku do shkojnë se unë e kam parasysh me detaje këtë si investim dhe banorët e kanë këtë shqetësim. A do të ketë kulet projekti në krahun e sipërme që të kanalizojë ujrat e bardha dhe në fund të gjësë ku do ti çojse do vij deri aty ku filloni investimin në qendër të fshatit ku shkojnë pastaj ujërat e bardha se ajo është e gjitha rrugë me pjerrësi.

Kryetari i Bashkisë – Për pjesën e ujrave të bardha se pjesa më e madhe vjen tek sheshi që është në Gjynoqarë do të bëhen me zgara metalike dhe gjithë ujë do vij atje dhe në krahë të rrugës është një përrua kur del poshtë. Do sistemohen që të gjithë ujrat që do të derdhen. Do këtë dy kanale që do të jenë më zgarë, do lidhen bashkë të dyja dhe do të shkojnë tek një perrua i vogël që është në krahë të djathtë sepse është problem që është ngritur dhe nga banorët edhe duhej të jepet një zgjidhje në momentin që të bëhet muri do të bëhet edhe kuletat sepse nuk kanë ndonjë kosto dhe ndonjë kohë të madhe se në momentin që po bën murin të bëhesh edhe kuletën anësore. Është gjë që zgjidhet.

Eduart Faslliaj –Ky investim do ta kënaqi komunitetin.

Armand Ahmetaj- Kush është dakord? 14 pro asnjë kundër miratohet.

Kryetari Bashkisë të lexohet relacioni.

Armand Ahmetaj- Për procedurë mund ta marrësh fjalën Ermenita.

Ermenita Mici - ky projektvendim ka të bëjë me miratimin e fondit të planifikuar në emergjencë civile e cila ishte parashikuar në vlerën prej 2,422,374 lekë për objektin blerje pajisje korse automatike për ndërhyrje në raste emergjente pas vlerësimit të tij objekti ku paralelisht ne kemi marrë dhe miratimin nga Agjencia Kombëtare Civile për financimin e blerje traktor dhe frezë kemi vlerësuar që ai mjet është i mjaftueshëm me funksione të ngjashme dhe në këtë mënyrë këtë fond ne duam që ta përdorim për ndërtimin e mureve përgjatë të rrugës Ymeraj në Gjynahqarë Në këto kushte i kërkojmë këshillit të miratojë këtë vlerë prej 22,422,374 lekë.

Faleminderit!

Keni ndonjë diskutim tjetër para se të kalojmë në votim? Atëherë kalojmë në votimin e pikës së katërt

Kush është dakord?


14 vota pro, abstenim ska, kundër ska, miratohet.

SEKRETARI

KRYETARI

Refaela Xeba

Armand Ahmetaj



Armand Ahmetaj
Eduart Faslliaj
Rendita Shyete